

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-140/13

Prishtinë,

26 mars 2015

Në çështjen juridike të:

E B

V

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

Kundër

Pala përgjegjëse në kërkesë- ankesë

Nuk ka

Kolegji i Apelit i AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Willem Brouwer and Esma Erterzi, anëtarë ,duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/175/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00490), i datës 22 dhjetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur me 26 mars 2015, morri këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohen si e pabazuar ankesa e E B paraqitura kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/175/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00490), i datës 22 dhjetor 2012.
2. Vërtetohet vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/175/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00490), i datës 22 dhjetor 2012.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe fakti

1. Me 14 mars 2007 E B në Agjencinë Kosovare të Pronës në Prishtinë, ka paraqitur kërkesën për njohjen e të drejtës së pronës private, duke pretenduar se është titullari i të drejtës së pronës së paluajtshme duke kërkuar ri posedimin e këtyre pronave të paluajtshme. Kërkesa e paraqitur është regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës KPA 00490 që i referohet ngastrës kadastrale 3001/14 me kulturë oborr, në vendin e quajtur “livadhet e mëdha” në sipërfaqe të përgjithshme prej 00.05.79 ha. Kjo pronë e paluajtshme është regjistruar në E B sipas fletës poseduese nr.4302 të lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi të Komunës së Vushtrrisë i dt.18 mars 2008.
2. Me këtë kërkesë ai pretendon se të drejtat pronësore në këto prona të paluajtshme nuk mund të ushtrohen për shkak të rrethana drejtpërdrejtë të ndërlidhura apo që rrjedhin nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë në periudhën 27 shkurt 1998 deri më 20 qershor 1999.

Për të mbështetur pretendimin e tij ai ka paraqitur një sërë provat dhe dëshmish dhe atë:

- Fletën poseduese të lëshuar nga Drejtoria Gjeodezike Komunale në Vushtri nr. 06-01/876 i datës 16 maj 2002 me të cilën konstatohet se ngastra kadastrale 3001/14 është regjistruar në emër të E B nga Vushtrria dhe se kjo ngastër kadastrale përbëhet prej shtëpisë në sipërfaqe prej 00.01.40 ha dhe oborrit në sipërfaqe prej 00.04.39 ha, të zonës kadastrale Vushtri.
- Kopjen e planit të lëshuar nga Kuvendi i Komunës – Vushtri me datë 16.5.2002. Me këtë kopje të planit po ashtu konstatohet se E B është regjistruar në cilësinë e bartësit të këtyre pronave të paluajtshme që është objekt i kërkesës.
- Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-70202016-04302 të datës 28.7.2008 me të cilën konstatohet se ngastra kadastrale 3001/15 është regjistruar në emër të E B ,
- Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë Ac.nr.132/95 i datës 6 prill 1995 është refuzuar ankesa si e pabazuar e E B dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Vushtri C.nr.110/94 i datës 5 dhjetor 1994. Objekt i shqyrtimit dhe i vlerësimit sikundër

aktgjykimit gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë ka qenë prona e paluajtshme që është edhe objekt i kërkesës së paraqitësit të kërkesës së E B.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur edhe një sërë provash tjera që i referohen objektit të kësaj kërkesë por që tërësisht dhe saktësisht i referohen provave të cilat janë paraqitur në paragrafin paraprak.

3. Në vitin 2007, 2010 dhe 2011 Ekipi i Notifikimit ka dalë në vend ku supozoheshin që gjendeshin prona e kërkuar dhe është vendosur lajmërimin përkatës në kët ngastër kadastrale.
4. Sipas Raportit të verifikimit të Agjencisë Kosovare të Pronës me datë 25 mars ,04 prill, 8 gusht 2008 dhe 25 shtator 2008 të gjitha dokumentet e theksuara janë vlerësuar pozitivisht.
5. Asnjë palë përgjegjëse nuk është paraqitur në AKP për të kontestuar apo pretenduar të drejtën e pronës në këto paluajtshmëri.
6. Sipas Raportit të përpunimit të Agjencisë Kosovare të Pronës të datës 4 shtator 2012 konstatohet se sipas evidencës së Zyrës Kadastrale në Vushtrri, ngastra kadastrale 3001/14 është ndryshuar në ngastrën kadastrale 3001/15. Me këto ndryshime është pajtuar edhe paraqitësi i kërkesës duke theksuar se kjo çështje juridike mund të procesohet edhe më tej sipas kësaj ngastre kadastrale të ndryshuar.
7. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK), me vendimin grupor KPCC/D/R175/2012 i datës 22.10.2012, ka hedhur kërkesën e E B me arsyetim se për këtë çështje juridike Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës nuk ka juridiksion. Në arsyetimin e këtij vendimi ankimor nën par. 21 theksohet se :”paraqitësi i kërkesës ka dështuar të demostojë se kërkesa e tij përfshinë rrethana që ndërlidhen drejtpërdrejtë ose që rezultojnë nga konflikti 1998/1999”. Kjo pikërisht për arsye se, paraqitësi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë provë juridikisht të vlefshme dhe nuk ka treguar asnjë fakt se kërkesa e tij ka të bëjë me këtë konflikt.
8. Paraqitësit të kërkesës vendimi i është dorëzuar më 15 prill 2013, ndërkaq i njëjti ka paraqitur ankesë më 30 prill 2013.

Pretendimi i ankuesit

9. Pala ankuese vendimin ankimor e kundërshton për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe procedurale si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Në ankesën e tij ai pretendon se kontesti lidhur me pronën që është objekt i kërkesës ka lindur në vitin 1977 në mes tij dhe anëtarëve tjerë të familjes por se një pjesë të kësaj prone e ka humbur më datë 19 qershor 1999. Prandaj, ai propozon ë të refuzohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës duke vërtetuar të drejtën e tij pronësore në pronën e kërkuar si dhe duke urdhëruar që H Q me anëtarë të tjerë të familjes të ç vendosen duke liruar katin e parë dhe pjesën e nën kulmit të kësaj prone.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesave

10. Sipas nenit 12.1. të Rregullores së UNMIK-ut nr.2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-079, pala mund të paraqesë kundër vendimit të Komisionit brenda afatit prej 30 ditësh nga njoftimi i palëve për këtë vendim.
11. Në rastin konkret vendimi i KPPPK-së i është dorëzuar ankuesit me datë 15 prill 2013 dhe se ai ka paraqitur ankesë me datë 30 prill 2013, e që është brenda afatit 30 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit mbi vendimin e këtij Komisioni.
12. Ankesa e ankuesit është e pranueshme ngase është paraqitur brenda afatit ligjor, por e njëjta është e pabazuar.

Meritat

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore sipas nenit 194 të LPK-së, konkludoi se ankesa e tij është e pabazuar.

13. Gjykata Supreme vlerëson se vendimi ankimor është i drejtë dhe i ligjshëm si dhe nuk është marrë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 1 dhe 2 të LPK. Drejt ka vendosur KPCC me vendimin ankimor kur ka hedhë kërkesën e paraqitësit të kërkesës për shkak të mungesës së juridiksionit. Kjo pikë është për arsye se ,mbi bazën e provave të paraqitura dhe fakteve të vërtetuara mosmarrëveshjet në mes të paraqitësit të ankesës dhe anëtarëve të familjes lidhur me pronën që është objekt i kërkesës kanë lindur më 1977 lidhur me të drejtën e shfrytëzimit të katit të parë dhe kulmit të shtëpisë që gjenden në ngastrën kadastrale nr. 3001/14 në vendin e quajtur “livadhet e mëdha” me kulturë shtëpi prej 0.01,41 ha dhe oborr prej 0.04.39 ha të regjistruar sipas fletës poseduese nr. 4302 të Komunës së Vushtrisë.
14. Rrjedhimisht mbi të mësipërme në bazë të provave të administruara dhe fakteve të vërtetuara pa mëdyshje mund të përfunduar se drejt është zbatuar dispozita e nenit 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03-L 079 ,kur është hedhur kërkesa e paraqitësit në mungesë të juridiksionit. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet se Gjykata Supreme ka juridiksion në rastet kur e drejta pronësore nuk mund të ushtrohet për shkak të rrethanave që lidhen direkt ose janë rezultat i konfliktit të armatosur që kanë ndodhur brenda periudhës kohore 27 shkurt dhe 20 qershor 1999.
15. Në rastin konkret sipas dëshmive të administruara por edhe sipas pohimit të ankuesit mosmarrëveshjet lidhur me pronën e kërkuar rrjedhin që nga viti 1977 dhe se, nuk i referohet ky kontest konfliktit të armatosur në periudhën e vitit 1998 1999.Pra ,ankuesi nuk ka arritur të tregojë

dhe mbështesë pretendimet ankimore se me këtë vendim ankimor është vendosur gabimisht përkitazi mungesës së juridiksionit të KPCC.

16. Nga sa u paraqit e me zbatim të dispozitës së nenit 13 par. 3 nënpar. (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03 –L – 079 u refuzua ankesa si e pabazuar duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
17. Sipas dispozitës së nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i formës së prerë i cili nuk mund të kundërshtohet me mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit,

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Esmat Erterzi, Gjyqtare e EULEX

Urs Nufer, Regjistruer i EULEX-it